**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria-Vlada-Government*

**Zyra e Kryeministrit – Ured Primijera – Office of the Prime Minister**

**Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë- Agencije za Hranu i Veterinarstvo- Food and Veterinary Agency**

# RREGULLORE NR. 04/2010
# PËR ORGANIZIMIN DHE FUSHËVEPRIMIN E BORDIT DREJTUES TË AGJENCISË SË USHQIMIT DHE VETERINARISË
# REGULATION N0. 04/2010
# ON ORGANIZATION AND FIELD OF ACTIVITY OF THE STEERING BOARD OF THE FOOD AND VETERINARY AGENCY
# PRAVILNIK BR. 04/2010
# O ORGANIZOVANJU I DELOKRUGRADA UPRAVNOG ODBORA AGENCIJE ZA HRANU I VETERINARSTVO

| | | |
|---|---|---|
| Qeveria e Republikës së Kosovës,<br>Në bazë të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 43.3 të Ligjit Nr. 03/L-016 për Ushqimin, | The Government of the Republic of Kosovo,<br>Pursuant to article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo and article 43.3 of the Law No. 03/L-016 on Food, | Vlada Republike Kosova,<br>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosova i člana 43.3 Zakona Br. 03/L-016 za Hranu, |
| Në pajtim me nenin 4 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007,<br>Nxjerr: | According to article 4 (3) of the Regulation on Work of Government Nr. 01/2007,<br>Issues: | U saglasnosti sa članom 4 (3) Poslovnika Rada Vlade Br. 01/2007,<br>Donosi: |
| **RREGULLORE NR. 04/2010<br>PËR ORGANIZIMIN DHE FUSHËVEPRIMIN E BORDIT DREJTUES TË AGJENCISË SË USHQIMIT DHE VETERINARISË** | **REGULATION N0. 04/2010<br>ON ORGANIZATION AND FIELD OF ACTIVITY OF THE STEERING BOARD OF THE FOOD AND VETERINARY AGENCY** | **PRAVILNIK BR. 04/2010<br>ZA ORGANIZACIJU I DELOKRUG RADA UPRAVNOG ODBORA AGENCIJE ZA HRANU I VETERINARSTVO** |
| **Neni 1<br>Qëllimi** | **Article 1<br>Objective** | **Član 1<br>Cilj** |
| Kjo rregullore përcakton organizimin dhe fushëveprimin e Bordit Drejtues të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe çështjet tjera të cilat nuk janë të përcaktuara në Ligjin Nr.03/L-016 për Ushqimin. | This regulation lays down organization and field of the activity of the steering board of the Food and Veterinary Agency and other issues which are not laid down in Law No..03/L-016 on Food. | Ovaj Pravilnik utvrdjuje organizaciju i delokrug rada Upravnog Odbora Agencije za Hranu i Veterinarstva i druga pitanja koja nisu utvrdjene Zakonom Br. 03/L-016 za Hranu . |
| **Neni 2<br>Përkufizimet** | **Article 2<br>Definitions** | **Član 2<br>Definicije** |
| Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë siç janë caktuar me Ligjin Nr. 03/L-016 për Ushqimin (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Ushqimin). | Terms used in this regulation shall have the same meaning as set out by Law No. 03/L-016 on Food (hereinafter Food Law). | Izrazi upotrebljenih ovom Pravilniku imaju isto značenje kako su utvrdjeni Zakonom Br. 03/L-016 za Hranu ( u daljem tekstu: Zakon o Hrani). |

| Neni 3<br>Organizimi i Bordit Drejtues | Article 3<br>Organization of Steering Board | Član 3<br>Organizacija Upravnog Odbora |
|---|---|---|
| 1. Bordi Drejtues i Agjencisë përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve siç është përcaktuar në nenin 43 të Ligjit për Ushqimin.<br>2. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues është tre (3) vjet.<br>3. Kryesuesin e Bordit Drejtues e zgjedhin anëtarët e bordit nga radhët e veta dhe mandati i tij është tre (3) vjet. | 1. Steering Board of the Agency is consisted of seven (7) members as it is articled in article 43 of the Food Law.<br>2. The mandate of the members of Steering Board is three (3) years.<br>3. The Chairperson of the Steering Board is selected by members of the Board and its mandate is three (3) years. | 1.Upravni Odbor Agencije sastoji od sedam (7) članova kako je utvrdjeno članom 43 Zako o Hrani.<br>2.Mandat Upravnog Odbora je tri (3) godine.<br>3.Predsedavajućeg Upravnog Odbora biraju članovi odbora iz svojih redova i njegov mandat je tri (3) godine. |
| **Neni 4<br>Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues** | **Article 4<br>The criteria for selection of the members of Steering Board** | **Član 4<br>Kriterijumi za izbor članova Upravnog Odbora** |
| 1. Udhëheqësit e institucioneve shtetërore propozojnë Anëtarët e Bordit Drejtues nga radhët e nëpunësve të institucionit të tyre. | 1. The leaders of the government institutions shall propose members of the steering Board from the personnel of the respective institutions. | 1.Rukovodioci Državne Institucije predlažu članove Upravnog Odbora iz redova službenika njihovi institucija. |
| 2. Nëpunësit e propozuar nga institucionet shtetërore, përveç kritereve të përgjithshme, duhet t'i përmbushin edhe kriteret në vijim:<br>2.1 të kenë përvojë pune në fushën e ushqimit, mbrojtjes së shëndetit publik dhe/apo mbrojtjes së shëndetit të kafshëve.<br>2.2 të jenë nëpunës të nivelit drejtues. | 2. The proposed personnel from government institutions ,except the general criteria, they must fulfill the following criteria as well:<br>2.1 they must have experience in the field of food, public halth protection and/or animal halth protection.<br>2.2 they must be employees of the managing level. | 2.Predloženi službenici državne institucije, pored opštih kriterijuma, treba da ispunjavaju i sledeće kriterijume:<br>2.1. da imaju radno iskustvo na polju hrane, zaštitu javnog zdralja i/ili zaštitu zdralja životinje,<br>2.2.da su službenici rukovodećeg ranga. |
| 3. Anëtarët e Bordit Drejtues nga institucionet tjera t duhet t'i përmbushin së | 3. Members of the Steering Board from other institutions must fulfill at least the | 3.Članovi Upravnog Odbora iz druge institucije treba da ispunjavaju i sledeće |

| | | |
|---|---|---|
| paku kriteret në vijim:<br>3.1 të kenë përgatitje të lartë shkollore,<br>3.2 të kenë përvojë pune në fushat që ndërlidhen me fushëveprimin e Bordit Drejtues dhe të Agjencisë.<br>3.3<br>4. Të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues duhet t'i përmbahen kufizimeve të përcaktuara me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. | following criteria:<br>3.1 must have University degree,<br><br>3.2 must have experience in the fjeld related to the field of activity of the Steering Board of the Agency.<br><br>4.All members of the Steering Board shall comprise restrictions laid down by legislation for prevention of the conflict of interest in exercising public functions. | kriterijume:<br>3.1 da imaju visoku školsku spremu,<br>3.2 da imaju radno iskustvo u poljima koja se nadovezuju sa delokrugom rada Upravnog Odbora Agencije.<br>4 Svi članove Upravnog Odbora treba da se podržavaju ograničenjima utvrdjenim zakonodavstvom za sprečavanje konflikt interesa na obavljanje javne funkcije. |
| **Neni 5**<br>**Fushëveprimi i Bordit Drejtues të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë** | **Article 5**<br>**Field of the Activity of the Steering Board of the Food and Veterinary Agency** | **Član 5**<br>**Delokrug rada Upravnog Odbora Agencija za Hranu i Veterinarstva** |
| 1. Përbërja dhe përgjegjësitë e Bordit Drejtues të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (në tekstin e mëtejmë: Bordi Drejtues) janë përcaktuar me Ligjin për Ushqimin.<br>2. Bordi Drejtues është përgjegjës për mbikqyrjen e strategjisë afatgjate të propozuar nga Kryeshefi i agjencisë, pas konsultimit me ministritë përkatëse dhe Këshillin Shkencor të agjencisë.<br>3. Bordi Drejtues në bashkëpunim dhe koordinim me Kryeshefin Ekzekutiv dhe Këshillin Shkencor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë siguron që politikat e përcaktuara për sigurinë dhe | 1. The structure and responsibilities of the Steering Board of the Food and Veterinary Agency (hereinafter Steering Board) are laid down by Food Law.<br><br>2. The Steering Board is responsible to oversee the long term strategy proposed by the Chief Executive of the Agency after consultations with respective Ministries and Scientific Council of the Agency.<br>3. The Steering Board in cooperation and coordination with Chief Executive and Scientific Council of the Food and Veterinary Agency shall ensure that policies laid down for food safety and | 1.Sastav i odgovornost Upravnog Odbora Agencije za Hranu i Veterinarstvo ( u daljem tekstu: Upravni Odbor) utvrdjeni su Zakonom o Hrani.<br><br>2.Upravni Odbor je odgovoran za nadzor dugoročne strategije predloženu od strane Izvršnog Načelnika, nakon konsultacije sa dotičnim ministarstvima i Naučnom Savetu Agencije.<br>3.Upravni Odbor u saradnji i u koordinaciji sa Izvršnim Načelnikom i Naučnom Savetu Agencije za Hranu i Veterinarstvo, obezbedjuje da utvrdjene politike za bezbednost i kvalitet hrane budu u skladu |

| | | |
|---|---|---|
| cilësinë e ushqimit të jenë në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe standardet ndërkombëtare. | quality are in compliance with needs of citizens and international standards. | sa potrebama gradjana i medjunarodnih strandarda. |
| 4. Bordi Drejtues miraton raportin vjetor të aktiviteteve të Agjencisë i cili i paraqitet nga Kryeshefi Ekzekutiv jo më larg se deri me 30 mars të vitit vijues për vitin paraprak. | 4. Steering Board approves the annual report of the activities of the Agency which is presented by Chief Executive, not later than 30 of March of the following year for the previous year. | 4.Upravni Odbor usvaja godišnji izveštaj aktivnosti Agencije koji podnosi Izvršni Načelnik ne duže od 30 mart dotične godine za prethodnu godinu. |
| 5. Bordi Drejtues miraton propozim buxhetin e agjencisë i cili i paraqitet nga Kryeshefi Ekzekutiv në pajtim me afatet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin për menaxhimin e financave publike. | 5. Steering Board approves budget proposal of the Agency which is presented by Chief Executive, in compliance with limits and procedures laid down by legislation for management of public finances. | 5.Upravni Odbor usvaja nacrt budžeta Agencije koji podnosi Izvršni Načelnik u skladu sa rokovima i utvrdjenim procedurama sa zakonodsavstvom o upravljanju javnim financijama i odgovornosti. |
| 6. Bordi Drejtues para datës 31 janar të vitit vijues miraton propozim programin e punës së agjencisë, i cili i paraqitet nga Kryeshefi Ekzekutiv. | 6. The steering board before January 31st of the following year approves program proposal of the work of Agency which is presented by Chief Executive. | 6.Upravni Odbor pre datuma 31 januara dotične godine usvaja predlog programa rada agencije, koji podnosi Izvršni Načelnik. |
| 7. Bordi Drejtues miraton raportin financiar të agjencisë i cili i paraqitet nga Kryeshefi Ekzekutiv në pajtim me afatet dhe procedurat e përcaktuara me legjislacionin për menaxhimin e financave publike. | 7. Steering Board approves the financial report of the Agency which is presented by Chief Executive in accordance with limits and procedures laid down by legislation for management of public finances. | 7.Upravni Odbor usvaja finansiski izveštaj Agencije koji podnosi Izvršni Načelnik u skladu sa utvrdjenim rokovima i procedurama sa zakonodavstvom o upravljanju javnim finansijama i odgovornosti. |
| 8. Bordi Drejtues duhet të merret me dhënien e këshillave agjencisë për të siguruar nivel të lartë të ushqimit të sigurt, përfshirë edhe ushqimin e kafshëve, shëndetin e kafshëve, përkujdesjen ndaj kafshëve si edhe cilësinë dhe sigurinë e ushqimit me prejardhje bimore dhe shtazore. | 8. Steering Board shall give advice to the Agency to provide high level of food safety including feed as well as food safety and quality of food of animal and plant origin. | 8.Upravni Odbor treba da daje savete agenciji radi obezbedjenja viši stepen bezbedne hrane, obuhvatajući i hranu za životinje, zdravlje životinje, staranje prema životinjama kao i kvalitet i bezbednost hrane biljnog i životinjskog prekla. |
| 9. Bordi Drejtues nuk duhet të involvohet | 9. Steering Board shall not be involved and | 9.Upravni Odbor ne treba da se involvira |

| | | |
|---|---|---|
| në ndikimin e menaxhimit ditor të Agjencisë.<br>10. Bordi Drejtues i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin dhe parimet e Ligjit për Ushqimin. | have impact in daily management of the Agency.<br>10. Steering Board of the Food and Veterinary Agency should act always in accordance with objective and principles of Food Law | na uticaj dnevne menadžiranje Agencije.<br><br>10.Upravni Odbor Agencije za Hranu i Veterinarstvo treba uvek da postupa u skladu sa ciljevima i načelima Zakon o Hrani. |
| **Neni 6**<br>**Shkarkimi i anëtarëve të Bordit Drejtues** | **Article 6**<br>**Relief of the members of Steering Board** | **Član 6**<br>**Razrešenje članova Upravnog Odbora** |
| 1.Anëtarët e Bordit Drejtues mund të shkarkohen nga Qeveria sipas propozimit te Bordit Drejtues me votat e shumicës së anëtarëve.<br>2.Institucioni, anëtari i të cilit është propozuar për shkarkim, mund të deklarohet lidhur me propozimin e Bordit Drejtues.<br>3.Shkaqet për të cilat mund të shkarkohet një anëtar i bordit janë:<br>3.1 dënimi me burg për ndonjë vepër penale,<br>3.2 kryerja e punëve në kundërshtim me fushëveprimin e Bordit Drejtues si dhe me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,<br>3.3 mospjesmarrja në tri mbledhje pa ndonjë arsyetim të bazuar.<br>4. Në rast të vdekjes, dorëheqjes ose | 1.Members of the Steering Board may be relived by Government, by proposal of Steering Board with majority of votes of the members.<br>2.Institution, the member of which is proposed for relief, can be declared regarding to the proposal of the Steering Board.<br>3.The reasons why a Board member could be relived as a member of the Board are:<br>3.1 if the member is sentenced for an criminal act,<br>3.2 performing work which is in contradiction with field of activity of the Steering Board ,as well as legislation for prevention of the conflict of interest during the exercise of the public function,<br>3.3 if the member does not participate in three meetings without any reason.<br>4.In case of death, resignation or relief of | 1. Članovi Upravnog Odbora mogu da se razrešu od Vlade na predlog Upravnog Odbora, većinom glasa članova.<br>2. Institucija, čiji je član predložen za razrešenje, može da se izjasni u vezi sa predlogom Upravnog Odbora.<br>3. Razlozi iz koji se može da se razreši član Odbora su:<br>3.1. Kazna zatvora za neku krivično delo,<br>3.2. Izvršavanje poslova u suprotnosti sa delokrugom rada Upravnog Odbora kao i sa zakonodavstvom na sprečavanje konflikt interesa za obavljanje javne funkcije.<br>3.3. ne prisustvovanje tri uzastopna sednice bez opravdanog razloga.<br>4. U slučaju smrti, ostavke ili razrešenje |

| | | |
|---|---|---|
| shkarkimit të anëtarit të Bordit Drejtues, Kryeshefi Ekzekutiv i agjencisë do të iniciojë procedurën për zgjedhjen e anëtarit të ri në pajtim me procedurën e paraparë në Ligjin për Ushqimin dhe me këtë rregullore. | the member of Steering Board, The Chief Executive of the Agency shall initiate procedures for selection of the new member in accordance with procedures laid down by Food Law and by this regulation. | člana Upravnog Odbora, Izvršni Načelnik agencije pokrenuće postupak za izbor novog člana u skladu sa procedurama utvrdjenim zakonom o Hrani i ovim Pravilnikom. |
| **Neni 7**<br>**Organizimi i punës së Bordit Drejtues** | **Article 7**<br>**Organization of the Work of the Steering Board** | **Član 7**<br>**Organizacija rada Upravnog Odbora** |
| 1.Bordi Drejtues mblidhet së paku një herë në tre (3) muaj.<br>2.Caktimi i mbledhjeve të Bordit Drejtues bëhet me iniciativë të Kryesuesit të Bordit Drejtues, Kryeshefit Ekzekutiv, apo me iniciativë të së paku tre anëtarëve të Bordit Drejtues.<br>3.Mbledhjet e Bordit Drejtues thirren në bazë të njoftimit të Kryesuesit të Bordit, me të cilin njoftohen anëtarët e Bordit, por jo më vonë se pesë (5) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.<br>4.Në raste të veçanta, mbledhjet mund të thirren në afat më të shkurtër nga Kryesuesi i Bordit Drejtues apo Kryeshefi Ekzekutiv.<br>5.Bordi Drejtues mund të takohet në mbledhje të jashtëzakonshme kurdoherë që kërkohet nga së paku tre anëtarë të Bordit Drejtues. Kërkesa duhet t'i drejtohet Kryesuesit të Bordit Drejtues apo Kryeshefit Ekzekutiv. | 1. The Steering Board shall meet at least once in three (3) months.<br>2. An arrangement of the Steering Board meetings is made by initiative of the Chairman of the Steering Board, Chief Executive of the Agency and of at least three members of the Steering Board.<br>3. Convocation of the Steering Board meetings are done by the Chairman and, but not later than five (5) working days of the meeting.<br>4. In specific occasions the meetings can be called in short deadline by the Chairman of the Board or Chief Executive.<br>5. The Steering Board can be met emergency meetings whenever it is required by at least three members of the Steering Board .The request must be addressed to the Board Chairman or, the Chief Executive of the Agency. | 1. Upravni Odbor zasedava najmanje jedan put u tri (3) meseca.<br>2. Zakazivanje sednice Upravnog Odbora vrši se inicijativom Presedavajućeg Upravnog Odbora, Izvršnog Načelnika, ili iniciativom najmanje tri članova Upravnog Odbora.<br>3. Sednice Upravnog Odbora sazivaju se na osnovu obaveštenja Predsedavajućeg Odbora, kojim se obaveštavaju članovi Odbora, najkasnije pet (5) radnih dana pre održavanje sednice.<br>4. U izuzetnim slučajevima, sednice se mogu zazivati i u kraćem roku od Presedavajućeg Upravnog Odbora ili Izvršnog Načelnika.<br>5. Upravni Odbor može da zaseda u vanrednim sednicama kad god se zahteva od najmanje tri članova Upravnog Odbora. Zahtev treba da se uputi Presedavajućeg Upravnog Odbora ili Izvršnom Načelniku. |

| | | |
|---|---|---|
| 6.Mbledhjet e Bordit Drejtues kryesohen nga Kryesuesi i Bordit Drejtues. | 6. Meetings of the Steering Board are chaired by the Chairman of the Steering Board. | 6.Sednice upravnog odbora predsedavaju se od Presedavajućeg Upravnog Odbora. |
| 7.Në mbledhjet e Bordit Drejtues, përveç Kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Këshilli Shkencor i AUV-së apo përfaqësues nga institucione tjera relevante në cilësinë e vëzhguesit pa të drejtë vote. | 7. In the meetings of the Steering Board, except the Chairman and Board members may be invited to participate representatives from the Office of the Prime minister ,Scientific Council of FVA, or representatives from other relevant institutions ,but only as observers but without the right of vote | 7.Na sednicama Upravnog Odbora, osim presedavajućeg i članova Odbora mogu se pozivati da prisustvuju sednicu i predstavnici Ureda Premijera, Naučnog Saveta Agencije za Hranu i Veterinarstva (AHV) ili predstavnici iz druge relevantne institucije u svojstvu posmatrača, bez prava glasa. |
| 8.Sipas nevojës dhe kërkesave, në mbledhjet e Bordit Drejtues mund të ftohen ekspertë të ndryshëm, përfaqësues të operatorëve të biznesit me ushqim dhe operatorëve të biznesit me ushqim të kafshëve, konsumatorët, si dhe institucionet kompetente dhe palët tjera të interesuara. | 8. If needed and if there is a request, in the meetings of the Steering Board may be invited different experts, representatives of food and feed business operators, consumers and other parties of interest. | 8.Po potrebi i zahteve, na sednicama Upravnog Odbora mogu da se pozovu raznih stručnjaci, predstavnici operatora biznesa sa hranom i operatora biznesa sa hranom za životinje, potrošači kao i ndležne institucije i druge zainteresovane stranke. |
| 9.Për mbajtjen e mbledhjeve të Bordit Drejtues është e nevojshme pjesëmarrja e së paku katër (4) anëtarëve. Nëse ky minimum nuk arrihet, atëherë takimi do të shtyhet për një ditë tjetër dhe njoftimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve. | 9. For the meetings of the Steering Board is necessary participation of at least four (4) members .If this required minimum is not achieved then the meeting shall be deferred for another day and new information shall be delivered to the members of the Board. | 9.Za održavanje sednice Upravnog Odbora potrebno je prisustvo najmanje čietiri(4) članova. Ukoliko ovaj minimum ne može da se postigne sednica će se odložiti za drugi dan a nova obaveštenja za sednicu dostavlja se svim članovima. |
| **Neni 8**<br>**Vendimet e Bordit Drejtues** | **Article 8**<br>**Decisions of the Steering Board** | **Član 8**<br>**Odluke Upravnog Odbora** |
| 1.Vendimet në Bordin Drejtues merren me shumicën e votave të anëtarëve prezent. | 1.Decisions of the Steering Board shall be taken by majority of the votes of the members present | 1.Odluke Upravnog Odbora donose se većinom glasova prisutnih članova. |

| | | |
|---|---|---|
| 2.Secili anëtar i Bordit Drejtues ka të drejtë vote në Bordin Drejtues dhe nëse votat janë të barabarta, vota e Kryesuesit të Bordit Drejtues vendos.<br>3.Secili anëtar i Bordit Drejtues mund të abstenoj nga votimi për marrjen e vendimeve ose për çfarëdo çështje tjetër për të cilin ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.<br><br>**Neni 9**<br><br>**Rekomandimet e Bordit Drejtues**<br><br>1. Bordi Drejtues mund të nxjerr rekomandime përkatëse në fushën e arritjes së objektivit kryesor të Ligjit për Ushqimin, me qëllim të ngritjes së nivelit të lartë të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve.<br>2. Rekomandimet e Bordit Drejtues përmes Kryeshefit Ekzekutiv procedohen tek institucionet përkatëse.<br><br>**Neni 10**<br>**Raportimi i Bordit Drejtues**<br><br>Bordi Drejtues i raporton Qeverisë së paku një herë në vit apo çdo herë tjetër kur kërkohet nga Qeveria. | 2.Every member of the Steering Board has one vote in the Steering Board, If the votes are equal then the vote of the Chairman shall decide.<br>3.Every member of the Steering Board may abstain from voting on decision making or for any other issue for which he/or she has personal or economical interest<br><br>**Article 9**<br><br>**Recommendations of the Steering Board**<br><br>1.Steering Board may issue respective recommendations in the achievement of main objective of Food Law with objective to increase of high level of protection of life and human health.<br><br>2.Recommendations of the Steering Board through Chief Executive are preceded to respective institutions.<br><br>**Article 10**<br>**Reporting of the Steering Board**<br><br>The Steering Board reports to the Government at least once a year or whenever it is required by the Government. | 2.Svaki član Upravnog Odbora ima pravo glasa u Upravni Odbor i ukoliko glasovi budu jednaki, odlučuje glas Presedavajućeg Upravnog Odbora.<br>3.Svaki član Upravnog Odbora može da se uzdrži od glasanje za donošenje odluke ili za bilo koje pitanje za koju on ili ona ima lični ili ekonomski interes.<br><br>**Član 9**<br>**Preporuke Upravnog Odbora**<br><br>1. Upravni Odbor može da donese odredjene preporuke iz polje dostignuća glavnog cilja Zakon za Hranu, u cilju podizanja visokog stepena zaštite života i zdravlje ljudi.<br><br>2. Preporuke Upravnog Odbora, preko Izvršnog Načelnika, prosledjuju se dotičnim institucijama.<br><br>**Član 10**<br>**Izveštavanje Upravno Odbora**<br><br>Upravni Odbor izveštava Vladu najmanje jedanput godišnje ili svaki put kada se zahteva od Vlade. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 11**<br>**Përgjegjësia për mbarëvajtjen e punës së Bordit Drejtues**<br><br>Kryesuesi i Bordit Drejtues është përgjegjës për organizimin dhe mbarëvajtjen e punës së Bordit Drejtues. | **Article 11**<br>**Responsibility for progress of the work of Steering Board**<br><br>The Chairman of the steering Board is responsible for organization and the progress of the work of Steering Board. | **Član 11**<br>**Odgovornost za tok rada Upravnog Odbora**<br><br>Predsedavajući Upravnog Odbora je odgovoran za organizaciju i tok rada Upravnog Odbora. |
| **Neni 12**<br>**Mbështetja administrative dhe logjistike për Bordin Drejtues**<br><br>1. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë i ofron Bordit Drejtues mbështetje administrative dhe logjistike.<br>2. Kryeshefi Ekzekutiv ndërmerr veprimet e nevojshme për ofrimin e mbështetjes administrative dhe logjistike për punën e Bordit Drejtues. | **Article 12**<br>**Administrative and logistic support to Steering Board**<br><br>1.Food and Veterinary Agency offers to the Steering Board administrative and logistic support.<br>2.Chief Executive shall take appropriate measures to offer administrative and logistic support for the work of Steering Board | **Član 12**<br>**Administrativna i logistička podrška Upravnog Odbora**<br><br>1. Agencija za Hranu i Veterinarstvo Upravnom Odboru pruža administrativnu i logističku podršku.<br>2. Izvršni Načelnik preduzima neophodne radnje za pružanju administrativnu i logističku podršku za rad Upravnog Odbora. |
| **Neni 13**<br>**Kompensimi i anëtarëve të Bordit Drejtues**<br><br>Kompensimi i anëtarëve të Bordit Drejtues përcaktohet me vendim të veçantë, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. | **Article 13**<br>**Compensation of the members of the Steering Board**<br><br>Compensation of the members of the Steering Board shall be defined by special decision, issued by the Government of the Republic of Kosovo. | **Član 13**<br>**Kompenzacija članova Upravnog Odbora**<br><br>Kompenzacija članova Upravnog Odbora određuje se posebnom odlukom Vlade Republike Kosova. |

| Neni 14<br>**Hyrja në fuqi** | Article 14<br>**Entry into force** | Član 14<br>**Stupanje na smagu** |
|---|---|---|
| Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.<br><br>Hashim Thaçi<br><br>______________________<br>Kryeministër i Republikës së Kosovës<br><br>Prishtinë, më _____________2010 | This regulation enters into force on the day of signature by the Prime minister of the Republic of Kosovo.<br><br>Hashim Thaçi<br><br>______________________<br>Prime minister Republic of Kosovo<br><br>Pristine, on ______________2010 | Ovaj Pravilnik stupa na smagu danom potpisivanja od strane Premijera Republike Kosova.<br><br>Hashim Thaçi<br><br>____________________<br>Premijer Republike Kosova<br><br>U Prištini, _______________2010 god. |